



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE

DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT
DREJTORIA E VLERËSIMIT TË ANKESAVE

Nr. 1380/5 Prot

Tiranë, më 02.9.2022

VENDIM

Nr. 25, datë 02.9.2022

PËR

URDHËRIMIN E AUTORITETIT PUBLIK

Në mbështetje të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikës 3 dhe 5 të nenit 24, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjës a) të nenit 31/1 të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar,

KONSTATOVA SE:

Ankuesi, Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, ka depozituar pranë Zyrës së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim “Komisioneri”) Formularin e Ankesës nr. 1380 Prot., datë 01.08.2022, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë” (në vijim “Autoriteti Publik”).

Në cilësinë e kërkesit, ankuesi, nëpërmjet e-mail-it datë 22.06.2022, depozituar në adresën Amela.Kora@financa.gov.al dhe info@financa.gov.al, ka kërkuar t’i vendoset në dispozicion informacioni/dokumentacioni në lidhje me:

- *Sa është shuma e fondeve/donacioneve të mbledhura nga subjekte private, organizata vendase e të huaja etj, si ndihmë për pasojat e tërmetit të datës 26.11.2019?*
- *Kopje të listës së donatorëve së bashku me shumën e dhuruar.*

Në mungesë të një përgjigje nga Autoriteti Publik, ankuesi, me pretendimin se është cenuar në të drejtën për informim, ka paraqitur ankim pranë Zyrës së Komisionerit duke i kërkuar ushtrimin e kompetencave që i njeh ligji për rastet e refuzimit të dhënies së informacionit.

Komisioneri pas shqyrtimit paraprak të ankesës, bazës ligjore dhe rrethanave të faktit të paraqitura në të, vlerësoi se ankesa përmbush kriteret formale ligjore, të përcaktuara në nenin 24 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit” (në vijim “LDI”).

Në ndjekje të procedurës për shqyrtimin administrativ të çështjes, Komisioneri, në përputhje me nenin 10 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, i cili parashikon: “*Organi publik siguron që të gjitha palët dhe persona të tjerë të përfshirë në procedurë të jenë në gjendje të ndjekin dhe të mbrojnë të drejtat dhe interesat e tyre ligjorë në mënyrë sa më efektive dhe të lehtë të jetë e mundur*”, me shkresën nr. 1380/1 prot., datë 02.08.2022 kërkoi të informohet lidhur me procedurën e ndjekur për trajtimin e kërkesës për informacion, si dhe sqarime për zotërimin e dokumentacionit të kërkuar.

Autoriteti Publik me shkresën nr. 14857/1 Prot., datë 09.08.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1380/2 Prot., datë 11.08.2022, ka kthyer përgjigje duke bërë me dije se: “*...informacioni i kërkuar mund të gjenerohet në faqen zyrtare të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, konkretisht në linkun: <https://financa.gov.al/llogari-solidariteti-per-demot-nga-termeti-2019-per-donacionet-e-shteteve-2/>. Në lidhje me listën e donatorëve, referuar shkresës së dërguar nga Komisioneri për Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale të datës 16.12.2019, ky informacion nuk mund të vendoset në dispozicion*”.

Pas përgjigjes së sipërcituar, ankuesi ka vijuar me ankimin e regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1380/3 Prot., datë 17.08.2022, duke theksuar se shkresa e sipërcituar nga Autoriteti Publik i referohet kufizimit të donatorëve vetëm në rastet kur donatorët janë persona fizik/individë dhe jo persona juridikë.

Në këto kushte, me qëllim marrjen e një vendimi sa më objektiv, Zyra e Komisionerit me e-mail-in datë 23.08.2022, kërkoi nga Autoriteti Publik qëndrimin përfundimtar në lidhje me këtë çështje.

Autoriteti Publik nëpërmjet e-mail-it datë 30.08.2022, ka rikonfirmuar qëndrimin duke sqaruar se: “*Në lidhje me ankesën e Qendrës “Res Publica” mbi pretendimin e zbardhjes së listës së donatorëve ju informojmë se këto donatorë të cilët kanë dhënë kontributin e tyre në lidhje me dëmet e shkaktuara nga tërmeti i vitit 2019 nuk kanë dhënë pëlqimin e tyre paraprak për publikim të emrave dhe shumën përkatëse. Personat juridikë apo fizikë që kanë bërë donacione dhe kanë dashur të bëhen publik, shumën e kanë publikuar në media. Bëhet fjalë për donacione dhe nuk ka asnjë detyrim ligjor që imponon Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë (në vijim, “MFE”) të bëjë publike këtë listë si e ardhur e shtetit.*”

Ndërkohë sjellim në vëmendje se informacioni mbahet dhe ruhet nga bankat e nivelit të dytë pasi transaksionet bëhen në këto banka dhe nga ana e MFE nuk mund të filtrohet ky informacion për një ndarje të donatorëve në persona fizikë apo juridikë.

Në këto kushte, MFE mban të njëjtin qëndrim për mos publikim të kësaj liste, pasi nuk mund të kenë asnjë ndikim me interes të publikut emrat konkretë të cilët zgjedhin të bëjnë donacione në rast fatkeqësie”.

Në vijim, ankuesi, nëpërmjet e-mail-it datë 01.09.2022, regjistruar pranë Zyrës së Komisionerit me nr. 1380/4 Prot., datë 01.09.2022, kërkon vijimin e ankimit dhe detyrimin e Autoritetit Publik të vendosë në dispozicion informacionin lidhur me pikën 2 *“Kopje të listës së donatorëve së bashku me shumën e dhuruar”*, të kërkesës për informacion datë 22.06.2022.

Në këto kushte, pas konsultimit të legjislacionit përkatës dhe dokumentacionit të administruar gjatë hetimit administrativ, Komisioneri vlerëson se argumentet e paraqitura nga Autoriteti Publik për mosvënien në dispozicion të informacionit të kërkuar nuk qëndrojnë.

Së pari: Në shkronjën “a” të pikës 1, të nenit 2, të LDI parashikohet se: *“Autoritet publik” është çdo organ administrativ i parashikuar në legjislacionin në fuqi për procedurat administrative, organet ligjvënëse, gjyqësore dhe ato të prokurorisë së çdo niveli, organet e njësisve të qeverisjes vendore të çdo niveli, organet shtetërore dhe entet publike, të krijuara me Kushtetutë ose me ligj”.*

Në kuptim të këtij parashikimi, Ministria e Financave dhe Ekonomisë është Autoritet Publik dhe subjekt i LDI, për rrjedhojë detyrohet për zbatimin e tij, duke garantuar njohjen e publikut me informacion në kuadër të transparencës.

Për të mundësuar realizimin e objektit dhe qëllimit të tij, LDI, në nenin 1 përcakton se: *“1. Ky ligj rregullon të drejtën e njohjes me informacionin që prodhohet ose mbahet nga autoritetet publike. 2. Rregullat e parashikuara në këtë ligj kanë për qëllim garantimin e njohjes së publikut me informacion, në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë, si dhe të formimit të pikëpamjeve për gjendjen e shtetit e të shoqërisë. 3. Ky ligj ka për qëllim edhe nxitjen e integritetit, të transparencës e të përgjegjshmërisë së autoriteteve publike.”*

Së dyti: Konstatohet se me shkresën nr. 1920/1 Prot., datë 16.12.2019, Komisioneri ka orientuar edhe më parë Autoritetin Publik lidhur me vënien në dispozicion të këtij informacioni i cili përkon edhe me objektin e ankesës objekt shqyrtimi.

Konkretisht, në këtë shkresë ndër të tjera citohet se: *“...sipas pikës 1, të nenit 3, të ligjit nr. 9887 datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, parashikohet se: “Të dhëna personale” është çdo informacion në lidhje me një person fizik, të identifikuar ose të identifikueshëm, direkt ose indirekt, në veçanti duke iu referuar një numri identifikimi ose një a më shumë faktorëve të veçantë për identitetin e tij fizik, fiziologjik, mendor, ekonomik, kulturor apo social”. Sipas këtij parashikimi, subjekt i ligjit për mbrojtjen e të dhënave personale janë vetëm personat fizik/individët dhe nuk përfshihen personat juridikë (donatorë).*

Sa më sipër, për ato të dhëna të cilat në kuptim të ligjit janë të dhëna personale mund të publikohen vetëm në rastin kur përmbushin njërin nga kriteret ligjore të parashikuara në nenin 5 dhe 6 të ligjit nr. 9887/2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar. Publikimi i listës së individëve që kanë dhuruar në Thesarin e Shtetit si ndihmë për dëmet e shkaktuara në tërmetin e 26 nëntorit, nëse nuk ka një detyrim ligjor për publikim, mund të bëhet vetëm pas marrjes së pëlqimit të subjektit të të dhënave personale.

Ndërkohë, në kuptim të pikës 2 të nenit 2 të LDI, “informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.

Në kuptim të këtij ligji, lista e donatorëve dhe shuma e dhuruar nga qeveria, subjekte ekonomike dhe entitete të tjera, do të konsiderohet informacion publik, për sa kohë nuk bie ndesh me parashikimet e nenit 17 të LDI, ku përcaktohen rastet e kufizimit të së drejtës për informim si dhe rastet kur dhënia e informacionit jepet në mënyrë të kufizuar.”

Megjithatë, edhe pse Autoriteti Publik ka pasur një orientim nga Komisioneri lidhur me këtë çështje, ai nuk mundi të provonte në asnjë moment, gjatë gjithë procesit të hetimit administrativ të ankesës, se në cilën pikë të nenit 17 të LDI e mbështet qëndrimin e tij lidhur me mosvënien në dispozicion të dokumentacionit të kërkuar, pasi është ky nen, i cili parashikon mundësinë e kufizimit të të drejtës për informim, shkaqet dhe arsyet që mund të çojnë një autoritet publik për të kufizuar të drejtën për informim, si dhe rastet përjashtimore nga ky rregullim.

Gjithashtu, në pikën 6 të këtij neni, parashikohet se: “...Autoriteti publik tregon qartë pjesët e dokumentacionit përkatës që janë refuzuar, si dhe në bazë të cilës pikë të këtij neni është bërë ky refuzim”.

Bazuar në këtë parashikim, si edhe në shkresën e Zyrës së Komisionerit nr. 1920/1 Prot., datë 16.12.2019, Komisioneri vlerëson se, Autoriteti Publik duhet të kishte analizuar dokumentacionin e kërkuar, duke provuar dhe argumentuar mbi cilën pikë të nenit 17 të LDI bazohet kufizimi i informacionit, analizë kjo e cila nuk rezulton të jetë bërë.

Së treti: Në lidhje me pretendimin e Autoritetit Publik se, informacioni i kërkuar nuk mund të ketë asnjë ndikim me interes të publikut për emrat konkretë të cilët zgjedhin të bëjnë donacione në rast fatëkeqësie, Komisioneri vlerëson se LDI nuk kushtëzon dhënien e informacionit/dokumentacionit të konsideruar publik me paraqitjen nga ana e kërkuarit të arsyeve apo interesit që ka në marrjen e këtij informacioni.

Në rastin konkret, Autoriteti Publik duhet të mbajë në konsideratë faktin se informacioni i kërkuar lidhet me menaxhimin e fondeve të përfituara në Thesarin e Shtetit dhe vënia në dispozicion e këtij informacioni do t'i shërbente edhe transparencës së veprimtarisë që ky autoritet ushtron.

Bazuar kjo, edhe në pikën 1 të nenit 3 të LDI, ku parashikohet se: “Çdo person gëzon të drejtën e njohjes me informacionin publik, pa u detyruar të shpjegojë motivet”.

Ndërkohë, bazuar në pikën 3 të nenit 3 të LDI, parashikohet se: “Çdo person ka të drejtë të njihet me informacionin publik, nëpërmjet dokumentit origjinal ose duke marrë një

kopje të tij në formën ose formatin që mundëson akses të plotë në përmbajtjen e dokumentacionit”.

Së katërti: Lidhur me argumentin e Autoritetit Publik se Ministria e Financave dhe Ekonomisë, nuk ka asnjë detyrim ligjor që imponon të bëjë publike këtë listë si e ardhur e shtetit, Komisioneri vlerëson se, edhe pse jo të shprehur në mënyrë literale, LDI bën një kategorizim të informacionit të aksesueshëm nga publiku në dy kategori kryesore: 1) *informacioni që bëhet publik pa kërkesë dhe 2) informacioni që vihet në dispozicion pas kërkesës së subjektit të interesuar.* Në kategorinë e parë, përfshihen ato kategori informacioni, të cilat publikohen dhe vendosen në dispozicion nga autoriteti publik, pa qenë i nevojshëm angazhimi i ndonjë subjekti, e cila është dhe kategoria për të cilën mund të qëndronte argumenti i paraqitur nga Autoriteti Publik. Ndërkohë, rasti konkret objekt shqyrtimi, i përket kategorisë së dytë, pasi kemi të bëjmë me një kërkesë për informim të depozituar pranë Autoritetit Publik, në përputhje me parashikimet e nenit 11 e vijues të LDI, e cila rrjedhimisht duhet trajtuar sipas këtyre dispozitave.

Për sa më sipër, Komisioneri vlerëson se, informacioni/dokumentacioni i kërkuar, përmbush kërkesat e pikës 2, të nenit 2, të LDI, sipas të cilit *“informacion publik” konsiderohet çdo e dhënë e regjistruar në çfarëdo lloj forme dhe formati, gjatë ushtrimit të funksionit publik pavarësisht nëse është përpiluar ose jo nga Autoriteti Publik”.*

Në këtë kuptim, Autoriteti Publik duhet të vendosë në dispozicion të kërkuarit çdo dokument i cili është prodhuar ose mbahet nga ky i fundit në formën e zotëruar, në përputhje me pikën 6 të nenit 17 të LDI.

Ndërkohë, në referencë të dispozitave të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, Ministria e Financave dhe Ekonomisë, në cilësinë e kontrolluesit të të dhënave personale, duhet të bëjë vlerësimin për përpunimin/përhapjen e të dhënave personale të subjekteve të të dhënave, në përputhje me parimet dhe kriteret ligjore të parashikuara, respektivisht, në nenet 5 dhe 6 të këtij ligji.

Përhapja e të dhënave personale konsiderohet përpunim dhe përpunimi i të dhënave personale legjitimohet vetëm nëse plotësohet një nga kushtet e sanksionuara në nenin 6, të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar.

Si përfundim, Komisioneri thekson se, LDI ka për qëllim të nxisë përforcimin e integritetit, transparencës e të përgjegjshmërisë së Autoriteteve Publike dhe çdo subjekti tjetër jo shtetëror, që ushtron funksione publike. E drejta për informim duhet parë e lidhur ngushtë me parimin e transparencës dhe llogaridhënies, si një shtyllë tjetër themelore e shtetit të së drejtës. Funksionimi i tyre është në interesin publik.

E drejta për informim, bën pjesë në grupin e të drejtave themelore të njeriut, të mbrojtura posaçërisht nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut (KEDNJ), e cila ka për qëllim t’i garantojë publikut njohjen me informacion në kuadër të ushtrimit të të drejtave dhe lirive të individit në praktikë.

Në pikën 2 të nenit 23 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikohet se: *“Kushdo ka të drejtë, në përputhje me ligjin, të marrë informacion për veprimtarinë e organeve shtetërore...”.*

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në shkronjat b) dhe ç) të pikës 5 të nenit 24, nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, shkronjën a) të pikës 1 të nenit 18 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar,

V E N D O S A:

1. Pranimin e ankesës nr. 1380 Prot., datë 01.08.2022, nga Qendra “Res Publica”, përfaqësuar nga z. _____, kundër Autoritetit Publik “Ministria e Financave dhe Ekonomisë”, me objekt “Ankim ndaj refuzimit për dhënie informacioni dhe kopje të dokumenteve zyrtare”.
2. Urdhërimin e Autoritetit Publik, për vënien në dispozicion të dokumentacionit sipas ankesës nr. 1380 Prot., datë 01.08.2022 duke respektuar kufizimet, në përputhje me pikën 6, të nenit 17, të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”, brenda datës 12.9.2022.
3. Kundër këtij vendimi palët kanë të drejtën e ankimit në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve nga marrja dijani, sipas nenit 25 të ligjit nr. 119/2014 “Për të drejtën e informimit”.
4. Ky vendim u shpall sot në datë 02.9.2022.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

